

VENDIM
Nr. 97, datë 9.5.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAÏK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT–KARAVASTA,
LUSHNJË DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 mwp**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/6 prot., datë 6.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Karavasta Solar’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mwp”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 261, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 6/29 prot., datë 22.12.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (datë 4.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 49, datë 23.3.2022, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar, i cili duhet të depozitohet nga ana e saj në ERE, brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 49/2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”, plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për centralin fotovoltaik, neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; 4.4.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;

Lejen nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar.

- Në lidhje me konstatimin se zona kadastrale e cituar në deklaratën mjedisore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) nuk përputhet me zonën kadastrale të cituar në dokumentacionin pronësor të depozituar nga ana e shoqërisë për qëllime të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria i ka dërguar shkresë AKM-së, më datë 8.4.2022, ku i është kërkuar korrigjimi i të dhënave kadastrale të deklaratës mjedisore. Në këto rrethana, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë depozitimi në ERE i përgjigjes së AKM-së, brenda datës 20.6.2022, duke marrë në konsideratë afatin prej 45 ditëve pune (duke filluar ky afat nga data e depozitimit të shkresës), brenda të cilit AKM-ja shprehet në lidhje me aplikimet, dhe duke i lënë 5 ditë kohë shoqërisë për të depozituar këtë dokument në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit–Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 mwp, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE, brenda datës 20.6.2022, përgjigjen/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me informacionin kadastral të deklaratës mjedisore për zhvillimin e projektit të Karavastasë.

3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushtit sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti